



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-26690 dt. 04/06/ 2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **23.05.2024**, ora **10:00**

Mbledhjen e kryesoi: Milnim Handari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës Rami Lladrovci, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), ndërsa mungoi Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend Dite:

1. **Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 22.04.2024.**
2. **Propozim vendim për ndarjen e parcelës kadastrale 326-4 Çikatovë e Re.**
3. **Të ndryshme.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime Kryesuesi i Komunës Milaim Hajdari hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: **(Për)**, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 22.04.2023.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota **(Për)**, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim vendim për ndarjen e parcelës kadastrale 326-4 Çikatovë e Re.**

Arbër Halilaj- e përkrahu këtë projekt për ndërtimin e këtij objekti për persona me prapambetje mendore për shkak që me sfidat të cilat përballën popullata në jetën e përditshme paraqesin nevojën që të përforcohet kujdesi ndaj shëndetit mendor, si pik mendoj që duhet të shkoj në kuvend dhe të aprovohet.


Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Të Ndryshme.**

Arbër Halilaj- nuk është diçka personale po edhe anëtarët tjerë të komitetit edhe të asamblesë kem pas probleme me proces imin e pagesave, mendoj që duhet të tregojnë më shumë profesionalizëm dhe saktësi në këtë drejtim dhe mos të përsëriten raste tilla. Mua prej fillimit të mandatit katër ose pesë herë më është përsërit ndoshta mundë me qenë edhe qeshje teknike, kërkoj që zyra e kuvendit të jenë më vigjilent në këtë aspekt.

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 10:20 min.

Procesmbajtëse:



Indira Olluri Thaçi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari